



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR POGRADEC

Nr. ____Prot.

Pogradec me 07 Qershor 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja të Drejtorise se Sherbimit Spitalor Pogradec” (MM2)-Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomik, (një OE të vetëm fitues)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Materiale mjekesore te konsumueshme 33140000-3

VLERA FONDI LIMIT /VLERA E PRITSHME E KONTRATËS ESHTË :3,804,612 leke (tremilioneeteteqindekatermijeegjashteqindedybedhjet) pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njesi është 26,434.11 Leke (njetetegjashtemijeekaterqindetridhj-etekaterpikenjembdhjet) pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën ”Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja të Drejtorise se Sherbimit Spitalor Pogradec” (MM2) me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Shënim*: Operatori Ekonomik i renditur i pari, me njohjen e renditjes nëpërmjet SPE dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të

pikës 2 të nenit 26 të VKM 285/2021 (Rregullat e Prokurimit Publik) e ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26,29,30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

Çertifikata kërkohet të jetë origjinale ose te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.1.2 Ofertuesi duhet te jete i certifikuar me ISO 9001:2015 per Import,eksport ,tregetim te materialeve mjekesore ose ekuivalente të vlefshme, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit. Çertifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer ne gjuhen shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1,3,4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomike duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit **limit / vlera e priteshme e kontratave për të cilat oferton. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiron minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit , në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës

Neni 77, pika 3, të LPP : Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Neni 43, pika 1, të VKM: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Neni 43, pika 2/c të VKM: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % te vleres se parashikuar te kontrates ,ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar, dhe ne procedurat e prokurimit sherbim konsulence.

2.3 Kapaciteti teknik:

Per sa i perket aftesise teknike e profesionale operatori ekonomik duhet te permbushet kerkesat e meposhteme minimale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023)**nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se perlllogaritur te fondit limit .

-Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses te kontrates , ku shenohen vlera , afati i perfundimit kontrates ose /dhe fatura tatimore te shitjes ,te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi ,ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.ose fatura tatimore të shitjes.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes , te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi ,dhe te deklaruar ne organet tatimore ,ku shenohen datat , shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara .

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit per secilin lot ,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë vendin e prodhimit të mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga kompania prodhuese/ MAH /ose nga Distributori zyrtar i Autorizuar nga prodhuesi per teritorin e Shqiperise,ku ne cdo rast teprovohet/

dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për lejin e tregëtimit të artikujve të tij. Autorizimi kërkohet të jetë origjinal ose i perkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter gjë mbeshtetje në pikat 2 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku është e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, Brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor.* Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregëtimit të pajisjeve mjeksore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjeksore”. *(e vlefshme vetëm për OE lokalë/vendas)*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1/a dhe 2 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, pika 2 nën 77 të ligjit nr 162/2020 ku citohet “Për sa i përket përshtatshmerisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregëtare. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjeksore”.*

2.3.5 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

(pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqese **oferten teknike**, per artikujt objekt prokurimi ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me **piken 1**, te **nenit 36**, te **Ligjit nr. 162/2020**, **“Per Prokurimin Publik”**, ne te cilen eshte e percaktuar se: . *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 pika të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një process specifik për një faze tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në considerate kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter eshte ne perputhje me piken 2, te nenit 40, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se:2. *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

2.3.7 Kerkohen te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e ofruar :

Dorezimi i kampioneve /mostrave te behet prane Autoritetit kontraktor , te mbyllura me ngjitese ne kuti jo transparente te vulosura , mostrat do te dorezohen prane KVO-se me ane te nje procesverbali te firmosur nga perfaqesuesi i operatorit oferutes dhe KVO-se , **ne daten 18 Qershor 2024 prej ores 08:00 deri me 16:00**

Mostrat e dorezuara duhet te jene te shoqeruara me listen e inventarizimit ku te jete percaktuar per cdo artikull prodhuesi dhe vendi i prodhimit dhe te identifikuara sipas nr. rendor ne shtojcen nr.5."Specifikimet teknike" te DST-ve.Nese ka mungesa mostrash per artikuj te vecante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar , atehere oferta do te quhet jo e regullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 a) të VKM nr. 285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

2.3.8 Operatori ekonomik te paraqes nje vetedeklarim ne rast se shpallet i sukseshem ,qe do te beje rregjistrimin e materialeve te mjekimit per te cilat eshte shpallur i sukseshem ne Regjistrin kombetar te pajisjeve Mjekesore prane Agjensise Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve mjeksore ne perputhje me nenin 13 te Ligjit 89/2014 i ndryshuar me ligjin 21/2020 date 5.3.2020

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 të LPP, nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

CERTIFIKATAT E CILËSISË

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 88 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi te njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për përlllogaritjen e fondit limit të hartuar nga grupi I punës në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

MM2 “ Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”.

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
	Materiale mjekimi per Anestezi - reanimacion		
1	Kanjule intravenoze	14G , me valvol	Copë
2	Kanjule intravenoze	16G , me valvol	Copë
4	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
5	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
12	Ventil tre-rrugesh		Copë
13	Ventil tre-rrugesh me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë
15	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
18	Sonde gastrike		Copë
20	Sonde rektale pediatrike		Copë
21	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
32	Kateter urinar	2 rrugesh, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë
33	Kateter urinar	2 rrugesh,20 ch, balon 30-50 ml	Copë
34	Kateter urinar	2 rrugesh, 18 ch, balon 30-50 ml	Copë
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë
	Shiringa, Age		
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
43	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
44	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
45	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
46	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
47	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë
48	Age 18G	sterile	Copë
49	Age 20G	sterile	Copë
50	Age 21G	sterile	Copë
51	Age 23G	sterile	Copë
	Materiale nje perdorimeshe per kirurgji		
58	Perparese kirurgu sterile	Perparese kirurgu me peshe jo me pak se 55 g / cm ² , me fundin e kraheve 8 cm te thurura me jake rrethore, me kemishe me materjal PP , e sterilizuar , me permasat L ; XL ; XXL. ngjyre jeshile ose blu	Copë
59	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me menge elastike dhe jake rrethore	Copë
61	Kapele kirurgu	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² , me lidhese poshte qafes, pa latex.	Copë
62	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² me fund elastik , pa latex.	Copë
63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë
64	Beze kirurgjikale sterile 50x75cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa 50x75cm	Copë
65	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer,	Copë

		7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	
66	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa te copes 75x90cm	Copë
67	Beze kirurgjikal sterile me vrime 200 x 250 cm	Cope e pathurur e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35 gr/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive,me permasa te copes 200 x 250 cm	Copë
68	Beze kirurgjikale sterile me vrime 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , diameter 5 cm , me buze adesive, me permasa te copes 75x90cm	Copë
69	Beze kirurgjikale sterile me vrime (100 x 150cm)	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 100 cm x 150 cm .	Copë
	Materiale qepes kirurgjikale		
	Sutura mendafshi		
74	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë
75	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-35	age 1/2 rrethore	Copë
78	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore	Copë
79	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë
80	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
83	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
84	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
86	Nylon- USP 4-0; Gjatesia fijes 45-50 cm; Dimensiononi i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë
	Sutura Sintetike te Absorbueshme		
95	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
96	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2-0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
97	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3-0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4-0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
99	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
101	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2-0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age	Copë
102	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3-0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age	Copë
111	Polydioxone-USP 2-0, Gjatesia fijes	me age 1/2 rrethore	Copë

	70-90cm; dimesnioni i ageve 25-35		
112	Polydioxone-USP 3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
	Suture Polipropileni		
120	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
123	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
126	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
128	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
130	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
	Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi.		
151	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, sipërfaqja jo me pak se 150cm2	Copë
152	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, sipërfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë
	Sutura per okulistike		
156	Polyamide 6 dhe 66- USP 10-0, Gjatesia e fijes 30-45 cm, Dimensioi i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë
	Dezifektante Mjekesore dhe Kirurgjikale		
171	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberculocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa-aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perfimin e solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldyhe, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	litra
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel.Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)	litra

174	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti përmban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , perdoret duke u tretur 20 ml ne 1 liter uje	litra
175	Xhel shumeperdorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem për ta përdorur , pa nevojën përdorimin e ujit për shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra
176	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët për desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur	litra
177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra
178	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra
181	Dezinfektante ambjenti	Rodenticid, perberes aktiv Coumatetralyl - 0.0375 g / 100 g	pakete 10 gr

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikime teknike te pergjithshme

Afati i skadencës: jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës. Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Në lidhje me *kushtet e veçanta për kualifikim*, njësia e –prokurimit bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe furnizimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)